



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 04 Qershor 2008 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021 duke u bazuar edhe në Shkresën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 5928-2/22 të datës 19.10.2022, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.10.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

NDRYSHIMIN E TITULLARIT TË PALUAJTSHMERISË NGA SHKOLLA FILLORE BANULLE NË KOMUNA LIPJAN

I.NDRYSHOHET emërtimi i titullarit të paluajtshmërisë -njësisë kadastrale P-71409003-00959-2 në vendin e quajtur "Rosula" me sipërfaqe prej 20539 m² në ZK Banullë nga **Shkolla fillore Banullë në Komuna Lipjan.**

II.SHFUQIZOHET, Vendimi i Kuvendit të Komunës për përcaktimin e destinimit dhe ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga Shkolla Fillore Banullë në Komuna Lipjan 15Nr.463/01-52745 i datës 28.09.2022.

III.Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit nga Shkolla fillore Banullë në Komuna Lipjan siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati i Arsimit.

V.Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

15 Nr. 463/02-59176
Lipjan, më 31.10.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

